

L I G J
Nr.8023, datë 2.11.1995

PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE TË MATERIALEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT TË IMPORTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E AEROPORTIT TË RINASIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

1. Përfshihen nga të gjitha taksat doganore të importit dhe nga taksat e qarkullimit të importeve materialet dhe pjesët e këmbimit të importit që do të vijnë për aeroportin e Rinasit në adresë të Albtransportit dhe ANTA-s dhe që do t'i shërbejnë rikonstruksionit të plotë të tij, si vijon:

- 1.1. Makineritë, pajisjet dhe aparaturat.
- 1.2. Materialet, lëndët e para, lëndët ndihmëse dhe kimikatet.
- 1.3. Pjesët e ndërrimit, lubrifikantet dhe gomat.
- 1.4. Mjetet ngritëse transportuese për bagazhet dhe mallrat.
- 1.5. Mjetet e hipjes e të zbritjes së pasagjerëve në avionë dhe të transportimit të tyre në aeroport.
- 1.6. Pjesët dhe aparaturat e kontrollit të trafikut ajror, mjetet navigacionale, pjesët e këmbimit dhe materialet ndihmëse.
- 1.7. Pajisjet dhe aparaturat e radiondërlidhjes dhe telekomunikacionit, pjesët e këmbimit dhe materialet ndihmëse.
- 1.8. Automjetet, impiantet, aparaturat e mbrojtjes nga zjarri, pjesët e këmbimit, lëndët kimike dhe materialet ndihmëse të caktuara për këtë qëllim.
- 1.9. Automjetet, aparaturat e materialet ndihmëse për shërbimin shëndetësor në aeroport.
- 1.10. Pajisjet, aparaturat e ruajtjes, të sigurimit dhe mbrojtjes së aeroportit, materialet dhe pjesët e këmbimit të tyre.
- 1.11. Pajisjet, aparaturat, pjesët e këmbimit për sistemet e ndriçimit në aeroport, si dhe materialet e lëndët ndihmëse.
- 1.12. Pajisjet, aparaturat për informatizimin e shërbimit në aeroport dhe në agjencinë e biletave, pjesët e këmbimit dhe materialet ndihmëse të tyre.
- 1.13. Pajisjet e kompletimit të të gjitha mjediseve dhe zyrave në aeroport, agjenci, ANTA etj.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1282, datë 15.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha